



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2020:004924

Datë: 08.11.2021

Numri i dokumentit: 02402452

C.nr.101/20

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ, Departamenti I Përgjithshëm, gjyqtarja Mirlinda Bytyqi Rexhepi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit- kundër i padituri S.V. nga Mitrovica, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Av. Besart Kadriu me seli në Mitrovicë, kundër të paditurës-kundërpaditësit N.T.SH “ A...” me seli në Ferizaj, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Av. Gazmend Rexhepi për kompensimin e të ardhurave në vlerë prej 2.808€, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor në prani të autorizuarit të paditësit si dhe të përfaqësuesit të paditurës, me dt. 11.10.2021, mori ndërsa më dt. 08.11.2021 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I.REFUZOHET në tërësi padia dhe kërkesëpadia e paditësit-kundër të paditurit S.V. nga Mitrovica, kundër të paditurës-kundërpaditësi N.T.SH “ A...” me seli në Ferizaj për kompensimin e të ardhurave në shumën prej 4.808€, **si e pabazuar.**

II. REFUZOHET kundërpadia e të paditurit- kundërpaditësi N.T.SH “ A...” – me të cilën ka kërkuar që të DETYROHET paditësi- kundër i padituri S.V. që të paditurit- kundërpaditësit ti paguaj shumën prej 9.000€, **si e pabazuar.**

III.Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi- kundër i padituri S.V. nga Mitrovica përmes të autorizuarit të tij, ka ushtruar padi me dt. 16.01.2021 kundër të paditurës –kundërpaditësit N.T.SH “ A...”, për kompensimin e të ardhurave dhe dëmshpërblim për shqetësim.

I autorizuari i paditësit-kundër i padituri av.Besart Kadriu në padi si dhe në seancë gjatë fjalës përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesë padisë dhe theksimeve paraprake duke deklaruar se gjatë procesit gjyqësor u vërtetuan faktet se paditësi është dëmtuar nga i padituri materialisht, pasi që ka qenë i punësuar te i padituri dhe nuk është paguar për 3 muaj dhe i cili borxh është në shumën 2.808.00€, shumë e cila vërtetohet qartë edhe me llogari bankare, por edhe nga provat të cilat i ka sjell i padituri lidhje me këtë rast. Sa i përket kundërpadisë së të paditurit A... ka deklaruar se në asnjë seancë të vetme nuk e ka dëshmuar se e njëjta ka baza juridike, sepse nuk u vërtetuar me asnjë provë të vetme se paditësi Sefer Voca ka pasur për detyrë krijimin e softwerit të ri, sepse në kontratën të cilën e ka nënshkruar paditësi me rastin e punësimit, shihet qartë titulli i vendit të punës inxhinier i IT dhe askund nuk shënon se i njëjti është zhvillues i programeve.

Sa i përket dëshmisë së dëshmitarëve, të njëjtin me asnjë fakt të vetëm nuk e kanë dëshmuar se paditësi ka pasur për detyrë që të krijoj një softwer të ri, si dhe ka theksuar se dëshmitarët kishin tendencë që të mbajnë anën e firmës. Kurse nga dëshmia e pronarit të firmës u vërtetua qartë se në asnjë rast palët ndërgjyqëse nuk kanë pasur marrëveshje për krijimin e softwerit të ri, por mirëmbajtja e tij aktuale po ashtu edhe pretendimet në lidhje me shumën të cilën e ka kërkuar e paditura nuk qëndron sepse e paditura nuk ka sjellur asnjë dëshmi materiale. Andaj në bazë të dhënieve dhe provave në shkresat e lëndës, kërkon nga gjykata që ta aprovoj në tërësi kërkesë padinë e paditësit, kurse sa i përket kundërpadisë i propozon gjykatës që ta refuzoj në tërësi.

I ka kërkuar shpenzimet procedurale dhe atë për padi shumën prej 104€, përgjigje në padi 104€, për taksën gjyqësore 40€ dhe për seanca gjyqësore 540€.

E paditura-kundërpaditësja përmes përfaqësuesit të saj në fjalën përfundimtare ka deklaruar se gjatë shqyrtimeve gjyqësore është vërtetuar se padia e paditësit është e pa bazuar kurse kundërpadia është e bazuar dhe atë bazuar në faktet, provat dëgjimin e dëshmitarëve si dhe dëgjimin e palëve ndërgjyqëse. Duke theksuar se paditësit-kundër i padituri fillimisht ka provuar të mohoj faktin se ka pasur për qëllim krijimin e një softweri të ri, por këtë fakt e kanë pohuar dëshmitarët ashtu edhe provat që i kanë dorëzuar në gjykatë. Dëshmia dëshmitares K.D. ku tregon në detaje takimin se paditësi ku ka pasur të dorëzoi një program, por që Seferi nuk e ka dorëzuar me arsyetimin në email nuk ka qenë peroni me emrin A. dhe për këtë nuk e ka dorëzuar. Gjithashtu edhe dëshmia e dëshmitarit A.S. ka deklaruar se S.V. ka punuar si zhvillues softweri dhe se projektin ka pasur ta dorëzoi për punën që e ka bërë dhe nuk e ka

dorëzuar me arsyetimin se dëshmitari A. ka qenë në takim. Pas deklarimit të paditësit – kundëripadituri e paditura ka sjell një provë dëshmoj të kundërtën e asaj që S.V. kishte deklaruar, dhe nga provat e dorëzuar shihet qartë se çështja ka qenë komunikimi me email se kërkesa ka qenë rreth programit të ri, po ashtu edhe nga prova tjetër shihet se kundër i paditurit e ofron formën e aplikacionit të ri për testim ku vet i shkruan se këto janë pikat kryesore të projektit si dhe ku vet kundërpaditësi e paralajmëron për padi në Gjykatë se që 9 muaj kishte investuar nga 1000€ dhe projekti nuk u realizua. Duke u bazuar në këto të thëna kërkon nga gjykata që padinë e paditësit ta hedh poshtë si të pa bazuar, sepse paditësi është duke kërkuar shumën të cilën nuk e ka punuar fare, kurse ta aprovojë kundërpadinë dhe atë në shumë prej 9000€ me kamat ligjore prej 8% nga data e paraqitjes së padisë deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit. Gjithashtu kërkojnë edhe shpenzimet e procedurës në shumën totale 881€ dhe atë për 5 seanca nga 135€, për përgjigje në padi 104€ dhe për kundër padi 108€.

Gjykata për të vërtetuar gjendjen faktike ka bërë nxjerrjen e provave: Kontrate pune me kohë të caktuar – të pacaktuar e lidhur ndërmjet paditësit dhe të paditurës, qarkullimi bankar për paditësin, kërkesë e datës 11.11.2019, Përgjigja ne padi, Kundërpadia, Përgjigje në kundër padi e datës 26.11.2020, parashtresë e datës 08.09.2021, parashtresë e date 05 .10.2021.

Bazuar në provat e administruara dhe vlerësimit të tyre një nga një dhe të gjitha së bashku, në kuptim të nenit 8 të LPK-së, gjykata ka vërtetuar se kërkesë padia e paditësit- kundër të paditurit është e pa bazuar, si dhe kundërpadia e të paditurit- kundërpaditësit është e pa bazuar.

Nga kontrata e punës e datës 01.12.2010 gjykata vërtetoi faktin i cili nuk ishte kontestuese në mes të palëve se paditësi – kundër i padituri S.V. kushte qenë i punësuar tek e paditura – kundërpaditësja, dhe në bazë të kësaj kontratë detyrë e tij në punën e tij në NTSH A... në bazë të nenit 2 ka qenë IT/ingjinier për teknologji.

Nga emailat zyrtar të komunikimit në mes të paditësit- kundër të paditurit S.V. dhe pronarit të të paditurit B.M., vërtetohet fakti se paditësi në bazë të marrëveshjes që ka pasur me pronarin e të paditurës ka pasur për detyrë të krijoj softwerin e ri pasi nga i gjithë komunikimi në mes tyre me emaili vërtetohet fakti se B.M. i kërkon të njëjtit raport në lidhje me gjendjen aktuale të LIWS projektit.

Paditësi në komunikimin me email të datës 15.10.2018 në ora 09:42 i ka dërguar B.M. pikat kryesore të projektit, pastaj me datë 21.10.2018 paditësi ika dërguar linkun ku është publikuar versioni për testim. Pastaj me datën 08.11.2018 B.M. i ka dërguar email S.V. ku në rreshtin e 6 të emailit shënon ‘*Nga ai moment dje unë të drejtën time për tu dëmshpërbly me investimet e mia për këtë software do i orientoj përmes gjykatës për të kërkuar dëmshpërblimin që do e caktoj me vonë i cili më është bërë*’.

Gjykata nga këto emaila të shkëmbyer në mes të paditësit dhe të paditurës vërteton faktin se detyrë e paditësit ka qenë krijimi i softwerit të ri, ashtu siç pretendon e paditura, për këtë arsye edhe ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar, ndërsa kundërpadinë e të paditurës e ka refuzuar me arsyetimin se shumica e kërkuara prej 9 euro është shumë jo e vërtetuar me ndonjë provë konkrete, pasi edhe vet B.M. në seancën e datës 06.09.2021 ka deklaruar se ‘*vlera e dëmit të shkaktuar mund të jetë hipotetike*’, nuk mund ti fal besimin lartësisë së kërkuar për shpërblim dëmi, pasi e njëjta nuk është shumë e precizuar qoftë me ekspertizë financiare apo me ndonjë provë materiale. Gjithashtu është vërtetuar fakti se problemet apo mospajtimet në me të palëve kanë lindur 9 muaj pas lidhjes së kontratës së punës, dhe për 9 muaj që paditësi ka punuar tek e paditura është kompensuar, ndërsa për 3 muajt e fundit paditësi me asnjë provë nuk e ka vërtetuar faktin se edhe pse ka pasur mospajtime me të paditurën, i njëjti ka punuar edhe për 3 muajt që kërkon të kompensohet.

Dëshmitarja K.D. në deklaratën e saj të dhënë së seancën gjyqësore të datës 04.02.2021 ka deklaruar se S.V. e njeh padi që të njëjtin e ka pasur *teamlid* kur ka punuar tek firma finker Market, ndërsa të paditurën NTSH A... ka punuar si programere deri para një muajit. Dëshmitarja ka deklaruar se ka filluar të punoj në kompaninë A... me datë 01.06.2019 me rekomandimin e S.V., kurse së bashku me S.V. nuk ka punuar asnjëherë. Ka theksuar se pronari i kompanisë B.M. i ka treguar se S. ka pasur për detyrë që të dorëzoj një punë që e ka kryer në një vend të caktuar dhe në atë vend kanë pasur që të shkojnë dëshmitarja dhe A. dhe aty janë takuar me S. që ai të ia dorëzoj projektin e punuar pasi që dëshmitarja ka qenë e punësuar si programere dhe ai takim nuk ka pasur rezultat pasi që S. nuk i ka dorëzuar asgjë, me arsyetimin se ai ka qenë i njoftuar përmes emailit se K. do të shkonte në takim, mirëpo meqenëse ka qenë prezent edhe A. i cili nuk ka qenë i përfshirë në email nuk i ka dorëzuar asgjë. Sipas dëshmitares ai projekt nuk ishte dorëzuar asnjëherë deri sa ajo kishte punuar tek kompania dhe pas ndërprerjes së kontratës i ka dorëzuar të gjitha pajisjet fizike, si programin që ka punuar tek kompania-udhëheqësit e saj.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 04.02.2021 është dëgjuar edhe dëshmitari A.S. i cili ka deklaruar se S.V.-paditësin e njeh si person por si jo diçka më shumë, ndërsa në firmën A... punon si zhvillues i softverit. Me datë 07.11.2019 janë takuar me paditësin tek ... në Prishtinë, takimi ka qenë lidhur me dorëzimin e projektit nga S.V. tek dëshmitari dhe K., pasi që i njëjti ka punuar tek e paditura dhe kur e ka lënë punën nuk e ka dorëzuar projektin dhe atë ditë pa pasur për ta dorëzuar, mirëpo ai projekt nuk është dorëzuar me arsyetimin se A. nuk ka qenë i përfshirë në email, dhe meqë nuk ka qenë i përfshirë nuk e ka dorëzuar. A. në kompani ka punuar si Zhvillues i softverit por nuk ka njohuri se çfarë detyra ka pasur S.V. pasi që nuk e ka parë kontratën e tij .

Në cilësinë e dëshmitari është dëgjuar paditësi në seancën e datës 06.09.2021 i cili ka deklaruar se tek e paditura është punësuar rreth vitit 2018 dhe përgjegjësit e tij kanë qenë mirëmbajtja e sistemit ekzistues që e ka përdor sistemi shëndetësor ... dhe klinika tjetër që ka ofruar për shërbim A... për institucionet e tjera shëndetësore, kurse nuk ka pasur për detyrë që të krijoj ndonjë program të ri pasi që detyrat e tij kanë qenë vetëm mirëmbajtja. E paditura nuk ka qenë korrekte me pagat dhe ka ndodhur që paga nuk është ekzekutuar e gjitha përnjëherë por një pjesë është paguar me cash kurse pjesa tjetër përmes bankës dhe vazhdimisht ka pasur vonesa. Në takimin me K. nuk ka nuk e ka ditur qëllimin e takimit ka menduar që ishte takim shoqëror pasi që me të njëjtën njiheshin më herët, kurse A. nuk e ka njohur aty janë takuar për herë të parë dhe kanë diskutuar lidhur me një kërkesë për një program që ka pasur për detyrë të krijoj paditësi por ai as tani nuk ka njohuri se çka po kërkohet nga ai, pasi që ka theksuar se a punuar vetëm si mirëmbajtës i sistemit.

Në seancën gjyqësor të datë 06.09.2021 është dëgjuar edhe dëshmitari B.M.- pronari i kompanisë i cili ka deklaruar se S.V. e njeh pasi që me të njëjtin kanë bashkëpunuar për 10 vite rreth punës së softwerit. Paditësi është punësuar në vitin 2018 për zhvillimin e një softweri të ri, aplikacion online dhe mirëmbajtjen e një softweri të vjetër ku paditësi ka qenë krijues i atij softweri. S. është punësuar vetëm si zhvillues i atij programi softwerik dhe kur ka qenë i punësuar në zyrën tek ... nevojat e herëpashershme që janë lidhur me programin e vjetër dhe pajisjet e nevojshme për këtë program është kërkuar që ti evitoj pasi që ka qenë mirëmbajtës dhe 95% të kohës e ka kaluar duke zhvilluar softwerin ku aty janë punësuar rreth 30 persona të tjerë. Softweri është softwer menaxhues i klinikave mjekësore për diku 7 vjet radhasi dhe bashkërisht kanë krijuar një softwer të vjetër i cili nuk ka mundur te përdoret online dhe

kërkesa tij për ta krijuar një softuer tjetër për përdorim online ka bërë që të punësohet dhe ta bëjë me të sigurtë mundësin e zhvillimit të këtij softueri. Me paditësin ka qenë në kontakt të vazhdueshëm duke e përcjell zhvillimin dhe kanë komunikuar përmes Viber, ku pas disa kohe e ka vërejtur që zhvillimi po ngadalësohet dhe kanë komunikuar duke i treguar se kanë humbur shumë kohë dhe para duke mos e paraqitur softwerin e ri në treg. Softwerin i padituri e ka pasur në shitje në të gjitha klinikat mjekësore ku kanë vepruar edhe me të vjetrin që e kanë shitur pasi e kanë blerë nga S. në vlerë prej 8000€. Vlera e dëmit të shkaktuar mund të jetë hipotetike, por duke pasur parasysh që para 6 muajve ka zhvilluar një program tjetër me një ekip tjetër dhe e ka shitur, ku për 6 muaj vlera e shitjeve të realizuara për atë softwer ka qenë rreth 30.000€, ku konsideron se për një vit sensibilizimi i softwerit nga shitjet mund të arrin vlera e kontratave në vlerë prej 100.000€, ky është dëmi i vonësës. Paditësi ka qenë i punësuar tek e paditura si IT e cila është informatikë teknologji ky hynë edhe pjesa softwerike.

Dëshmitë e dëshmitarëve për gjykatën ishin bindëse dhe reale sepse dëshmitë e të njëjtëve ishin në përputhje me provat e tjera në shkresat e lëndës, dhe emailit e shkëmbyer, as vet paditësi nuk e mohon faktin se është takuar me dëshmitarët në fjalë, por dëshminë e paditësit- kundër të paditurit gjykata nuk e vlerësoi si dëshmi të sinqert dhe reale, i njëjti me asnjë provë nuk ka arritur ta dëshmoj se ka punuar 12 muaj tek e paditura ndërsa është kompensuar vetëm për 9 muaj dhe e paditura i ka mbetur borxh edhe për 3 muaj t'ia kompensoj të ardhurat, pasi kompensimi i të ardhurave vjen si rezultat i punës që secili realizon dhe realizimin e detyrave që i kryen i njëjti.

Gjykata për të vlerësuar saktë dhe drejtë lidhur me këtë çështje juridike, pas shikimit në shkresa të lëndës erdhi në përfundim se nuk është kontestues fakti se paditësi-kundër i padituri ka qenë në marrëdhënie pune te e paditura- kundër paditësja nga fakti se pasi që një gjë e tillë nuk kontestohet nga palët, kjo vërtetohet nga deklaratat e palëve gjatë shqyrtimit të kësaj çështje dhe nga kontrata e punës, por kontestues ka qenë fakti se e paditura nuk i ka paguar paditësit 3 pagat e fundit në shumë prej 2,808 euro, fakt qe gjykata e ka refuzuar kërkesën e paditësit për kompensimi ne të ardhurave në shumë prej 2,808 euro sepse është vërtetuar fakti se edhe pse në kontratë paditësi ka qenë IT, i njëjti ka pasur për obligim krijimin e softwerit të ri, andaj nëse i njëjti edhe nuk i është përmbajtur detyrave të punës, andaj edhe e paditura nuk e ka kompensuar.

Andaj gjykata duke u bazuar në nenin 319 të LPK-së, në bazë të së cilës ‘*secila palë ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta*’’, si dhe nenin 322 të LPK-së në bazë të së cilës ‘*në qoftë se gjykata në bazë të provave të marra nuk mund të konstatoj me siguri ndonjë fakt, për ekzistimin e faktit, do të përfundoj duke i aplikuar rregullat për barrën e provave*’’, kërkesëpadia dhe kundërpadia.

Gjykata pretendimin e paditësit- kundër i padituri nuk ia falë besimin pasi nga dëshmitë e dëshmitarëve dhe nga provat e lëndës u vërtetua se paditësi- kundër i padituri ka pasur për detyrë të krijoj një softwer të ri, për të cilin edhe paguar në mënyrë të vazhdueshme nga e paditura dhe këtë detyrë nuk e ka përfunduar asnjëherë.

Gjykata me rastin e vendosjes gjithnjë ka pasur parasysh pretendimet e të palëve ndërgjygjëse por të njëjtat kanë qenë të pa qëndrueshme dhe nuk ka pasur bazë për të vendosur ndryshe.

Gjykata sa i përket vendosjes në lidhje me shpenzimet e procedurës ka vendosur konform nenit 457 të LPK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

C.nr.101/20, dt.08.11.2020

Gjyqtarja

Mirlinda Bytyqi Rexhepi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes në dorëzim, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.